



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË  
SKUPSTINA OPSTINE DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



## NJOFTIM

Bazuar në paragrafin 7.3 dhe 9 të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-139 të dt. 26.03.2009 për shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205 të dt. 28.10.2010, NJOFTOHEN të gjithë subjektet në listën e cila i bashkëngjitet këtij Njoftimi se :

1. Pas rinxjerrjes së Vendimit për Aprovimin e Kërkesës për shpronësim nr. 01-464\01-3389 të dt. 14.02.2023 Rishpallet Njoftimi i dt. 28.01.2022
2. Për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik të ndërtimit të rrugës për Pejë, Segmenti prej Gjykatës deri te Mjekësia e Punës “ Emin Duraku “, pas plotësimit të gjitha kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 4 të Ligjit nr. 03/L-139 për shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, Kryetari i Komunës së Gjakovës ka nxjerr Vendim nr. 01-464\01-3389 të dt. 14.02.2023 për Aprovimin e Kërkesës për shpronësim për ndërtimin e rrugës për Pejë, segmenti prej Gjykatës deri te Mjekësia e Punës “ Emin Duraku “
3. Komuna do të marrë një Vendim Preliminar mbi ligjshmërinë e shpronësimeve të propozuara brenda 30 ditëve kalendarike, pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit nr. 03/L-139 për shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, lidhur me organizimin e dëgjimit publik.
4. Çdo person i interesuar ka të drejtë të paraqes komentet e tij me shkrim lidhur me shpronësimin e propozuar, organit shpronësues brenda 10 ditëve kalendarike pas shpalljes së Vendimit nga Kryetari i Komunës së Gjakovës nr. 01-464\01-3389 të dt. 14.02.2023 për shqyrtimin e kërkesave për shpronësim.
5. Komuna do të mbajë një dëgjim publik lidhur me shpronësimin e përhershëm sipas kërkesës së bërë nga Komuna e Gjakovës për Zonat kadastrale : Gjakovë – Qytet; Gjakovë. J. Qytet; Jahoc, komuna Gjakovë.
6. Personat të cilët janë zyrtarë publik të Komunës në të cilën mbahet dëgjimi si dhe Pronarë ose Zotëruesit e Interesave në pronën e cila gjendet brenda Komunës në të

cilën mbahet dëgjimi, ose avokat ose përfaqësues të këtyre personave, kanë të drejtë të marrin pjesë në dëgjimin publik.

7. Secilit person të lartpërmendur i ipet mundësia për t'i shprehur gojarisht mendimet e tij/saj lidhur me shpronësimin e kërkuar në përputhje me paragrafin 2 dhe 4 të nenit 9 të Ligjit nr. 03/L-139 të dt. 26.03.2009 për shpronësimin e prone së paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205 të dt. 28.10.2010.
8. Çdo person i cili dëshiron të marrë pjesë ose shpreh mendimet e tij/saj në dëgjimin publik, duhet të sjellë me vete provat e arsyeshme (dokumente) të cilat dëshmojnë se ai/ajo është në fakt zyrtar publik, pronar ose zotërues i interesit ose avokat apo përfaqësues i ligjshëm i atij zyrtari publik, pronari ose zotëruesi i interesit.
9. Dëgjimi publik lidhur me shpronësimin e kërkuar të të drejtave pronësore apo të drejtave tjera në pronat e paluajtshme që ndodhen brenda juridiksionit territorial të komunës së Gjakovës do të mbahet me dt. 13 Mars 2023 në ora 10 në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Gjakovës, për Zonat Kadastrale : Gjakovë – Qytet; Gjakovë Jashtë Qytet; Jahoc
10. Në rast se prona e cila është objekt i kërkesës shpronësohet pas përmbylljes së procedurës së shpronësimit të iniciuar në përputhje me atë kërkesë, asnjë kompensim nuk do të paguhet për shpenzimet ose vlerën e çfarëdo përmasimi të bërë në pronë, objekteve të ndërtuara ose zgjeruara në prone, ose pemëve apo bimëve të mbjellura në prone pas datës së përmbylljes së dispozitave përkatëse të paragrafit 8 të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-139 dt. 26.03.2009, për shpronësimin e pronës së paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205 të dt. 28.10.2010.
11. Çdo person i cili nuk është i emëruar në njoftim dhe i cili pretendon se zotëron një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në cilëndo ngastër të pronës së paluajtshme të përshkruar në njoftim, menjëherë duhet të dërgoi në organin shpronësues një përshkrim të pretendimit të tij/saj, bazën juridike të atij pretendimi si dhe kopjet e certifikuara të çfarëdo dokumenti që ndërlidhet me atë pretendim.